

KONTRATË

PËR SHIT-BLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDERMJET OSHEE sh.a DHE PRODHUESVE ME PERPARESI TE ENERGJISE ELEKTRIKE

E lidhur sot me datë ____/____/____/, në Tiranë, ndërmjet;

Shoqërisë _____, person juridik shqiptar, regjistruar në _____
me vendim nr. _____, me nr. NIPT-i _____ me seli të shoqërisë
_____, ketu e me poshte e quajtur **“Shitesi”**, perfaqesuar nga
Zj/Z _____;

dhe

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike OSHEE sh.a., Shoqeri Aksionare,
regjistruar si person juridik _____ me seli ne adresen:
rruga _____ Tirane, ketu e me poshte e quajtur **“Blerësi”**, perfaqesuar
nga Zj./ Z _____;

Duke gene se:

Shoqeria _____, ka marrë me koncesion /ka privatizuar, HEC-in/et _____,
sipas marrevshjes se koncesionit/sipas kontrates se shitblerjes _____;

Palet janë pergjegjese per permbushjen e detyrimeve sipas kesajkontrate;

ERE me vendim te saj nr. _____, date _____, ka licensuar Shoqerine
_____ per prodhimin e Energjise Elektrike; nga HEC/et _____ sic percaktuar ne
licensen e dhene nga ERE.

OSHEE sh.a. i cili eshte i ngarkuar me detyrimin i shërbimit publik për blerjen e energjisë
elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë duhet te nenshkruaje nje kontrate per
blerjen e Energjise Elektrike me Prodhuesit me Perparesi te Energjise Elektrike ne zbatim te
nenit 11, pika 2 te VKM nr.244, date 30.03.2016 *“Per miratimin e kushteve per vendosjen e
detyrimit te sherbimit public, qe do te zbatohen ndaj te licensuarve ne sektorin e e energjise
elektrike, te cilet ushtrojne aktivitetin e prodhimit transmetimi, shperndarjes dhe furnizimit
me energji elektrike”*.

ERE ka autoritetin të percaktoje cmimin e shitjes se Energjise Elektrike per Prodhuesit me
Perparesi te Energjise Elektrike sipas nenit 15, pika 3 te ligjit nr.138/2013 *“Per burimet e
rinovueshme”*.

Palëtbiën dakort si më poshtë vijon:

Neni 1 Përkufizime

Në këtë kontratë termat e mëposhtëm do të kenë kuptim si vijon:

- Çmimi** -do të thotë çmimi i shit-blerjes së Energjisë Elektrike, i vendosur nga Enti Rregullator i Energjise sipas legjislacionit në fuqi;
- Dita** -do të thotë një periudhe kohore prej 24 orësh e cila fillon në orën **00.00 deri në 24.00.**
- Energjia Elektrike/Energjia**- nënkupton energjinë elektrike aktive dhe energjinë elektrike reaktive të transmetuar dhe të shpërndarë nga sistemi elektro-energjetik
- Energji Elektrike Aktive:** - është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qarkelektrik gjatë një intervali kohe dhe percaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës. Njësia matëse e saj është Vat-Orë ose shumëfisha të saj.
- Energji Elektrike Reaktive** - është integrali i caktuar me kufije kohe i Fuqisereactive matur në njësi me volt-amper reaktive—ore ose shumëfisha të saj.
- ERE** - Enti Rregullator i Energjise;
- Frekuenca** - numri i cikleve alternative të rrymës për sekondë, në të cilin funksionon sistemi elektro-energjetik;
- Forcë Madhore** - është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë Palen/Palet kontraktuese të përmbushin detyrimet perkatëse sipas kesaj Kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të Pales/Paleve dhe nuk ndodhin për faj të tij/tyre dhe Pala/Palet nuk është/jane në gjendje t’I eliminojë ato, edhe pse ka/ne ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij/tyre. Defektet në paisjet ose materialet ose vonesat

per tibërë ato të disponueshme, konfliktet e punës, grevat ose problemet financiare nuk mund të kërkohet të konsiderohen nga Palët si Forcë Madhore, përvec rastit kur burojnë nga një rrethanë e lidhur me Forcën Madhore.

OSHEE sh.a.

- është personi juridik i licencuar përgjegjes per operimin e sigurte, te besueshem, dhe te efektshem te rrejtit te shperndarjes duke siguruar mirembajtjen dhe zhvillimin e sistemit te shperndarjes te shtrire ne nje zone te caktuar dhe kur eshte e aplikueshme lidhjen e tij me sisteme te tjera e te siguruar aftesi afatgjate te sistemit per te permbushur kerkesat e arsyeshme per shperndarjen e energjise, ne harmoni me mjedisin dhe eficenen e energjise i cili eshte i ngarkuar me detyrimin i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë ne zbatim te nenit 11, pika 2 te VKM nr.244, date 30.03.2016 *“Per miratimin e kushteve per vendosjen e detyrimit te shërbimit public, qe do te zbatohen ndaj te licensuarve ne sektorin e e energjise elektrike, te cilet ushtrojne aktivitetin e prodhimit transmetimi, shperndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*

Prodhuesit me perparesi

- janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike.

Kontrata

-kjo kontratë e nënshkruar për shitblerjen e Energjisë Elektrike, e lidhur midis Prodhuesit me perparesi te Energjise (Shitësit) dhe OSHEE sh.a (Blerësit) si dhe cdo shtesë apo amendim që mund t`i bëhet asaj në të ardhmen me konsensusin e paleve pas miratimit te ERE.

Ligj

Ligji nr. 43/2015, “Për Sektorin e energjisë elektrike”; Ligji nr. 138/2013, “Per burimet e energjise se rinovueshme”; ligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, te ndryshuar

- Matës** - d.m.th. një pajisje për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të Energjisë Elektrike.
- Muaji** - do të thote periudha kohore e cila fillon ne oren 00.00 p.d. te dites se pare kalendarike te muajit dhe mbaron ne oren 24.00 te dites se fundit kalendarike te po atij muaji.
- Palë** - **Shitësi** dhe **Blerësi** në këtë kontratë.
- Pikë Livrimi** - Për efekt të kësaj kontrate, pika e livrimit do të jetë **nje pike e sistemit elektro-energjitik** e percaktuar ne lejen e miraturar të lidhjes dhe ne marrëveshjen e lidhjes.
- Pikë Matje** - është Pika e Livrimit ne te cilen Sistemi i Matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE për këtë qëllim.
- Sistemi i Matjes së Energjisë Elektrike/Sistemi i Matjes,** - eshte tërësia epajisjeve të matjes: matësi, automati transformatorët e rrymes, mbrojtje e matësit dhe izolatorët,qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe të komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore, të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të Energjisë Elektrike Aktive dhe Energjisë Elektrike Reaktive në objekt;
- Viti** - do të thote periudha kohore e cila fillon ne orën 00.00 te ditës se pare te vitit kalendarik dhe mbaron ne oren 24.00 të dites se fundit te po atij viti kalendarik.

Neni 2

Qëllimi i Kontratës

Kjo Kontratë percakton termat dhe kushtet në të cilat Blerësi do të jetë i detyruar te bleje, dhe Shitësi do te jete i detyruar te shese te gjithë Energjine Elektrike te prodhuar nga Shitësi si Prodhues me Perparesi i Energjise Elektrike, ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi per kete qëllim.

Neni 3

Livrimi, Pranimi dhe Transferimi i të Drejtave

1. Shitësi, ne perputhje me kete kontrate duhet të programojë, të prodhojë e të shesë dhe Blerësi duhet të programojë, të pranojë dhe te blejë te gjithë sasine e prodhuar te Energjise Elektrike në Pikën e Livrimit.
2. Shitësi është i detyruar të marrë masat e duhura te lidhe impiantin prodhues te Energjisë Elektrike me Pikën e Lidhjes të përcaktuar, sipas specifikimeve dhe rregullave të përcaktuara ne Kodet e Rrjetit dhe aktete tjera.
3. Energjia Elektrike do të transmetohet nga Shitësi tek Blerësi në Pikën e Livrimit, ku dhe pronësia e Energjisë do të kalojë nga Shitësi tek Blerësi.
4. Blerësi do t'i paguajë Shitësit sasinë e blerë të Energjisë Elektrike me çmimin e kontratës dhe sipas rregullave te përcaktuara ne nenin 8 (faturimi dhe pagesa).
5. Bleresi bie dakort që të pranojë sasi të tjera shtesë të Energjisë Elektrike nga ana e Shitësit, në rast të një prodhimi më të madh nga ky i fundit. Për këtë Shitësi duhet të bëjë njoftimet përkatëse për ti mundësuar Blerësit marrjen e Energjisë si dhe rregullimin e programit të tij.
6. Pavarësisht detyrimit qe ka OSHEE për te blere te gjithë energjinë elektrike te prodhuar nga shitësi, shitësi ka te drejte te shesë te gjithë ose pjese te energjisë se prodhuar subjekteve te tjerë te ndryshëm nga OSHEE, ne sasinë dhe mënyrat e zgjedhura nga vete shitësi”. Grafiku i lëvrimit për energjinë qe do te shitet ne tregun e pa rregulluar do te jete ne bande sipas profilit 00:00 – 24:00.

Neni 4

Dokumentacioni Paraprak, Tensioni, Frekuenca

1. Shiteshi do t'i vere ne dispozicion/dorezoje Bleresit te gjithë dokumentacionin dhe te dhenat lidhur me testimet dhe transmetimin e Energjise, specifikimet teknike te gjithë paisjeve elektrike te instaluar perfs hire ketu edhe certifikatat especifikimeve, detajet e matesave dhe paisjeve te sigurise te instaluar, 30 dite perpara se impianti prodhues te vihet ne shfrytezim te plote e te filloje prodhim/livrimin e Energjise.
2. Energjia Elektrike duhet të livrohet me tension dhe frekuencë ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Neni 5

Programet e Livrimit

1. Impiantet prodhues me fuqi te instaluar mbi 5 MW duhet te programojne dhe te paraqesin tek Bleresi programet e levrimit ne perputhje me Rregullat e Tregut te Energjise Elektrike.
2. Impiantet prodhues me fuqi nen 5 MW do te paraqesin programin mujor/vjetor sipas sasise se Energjise Elektrike qe parashikohet te prodhohet.
3. “Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga OSHEE impiantet prodhues duhet te deklarojnë programet e tyre te livrimit dhe kontratat përkatëse për ditën ne avance”, si dhe planifikimin vjetor ku përcakton sasinë e energjisë elektrike qe shitësi do te shesë ne

OSHEE sh.a., dhe ne tregun e pa rregulluar te energjisë elektrike. Ky planifikim dërgohet ne OSHEE sh.a. brenda datës 30 Nëntor te vitit aktual për vitin pasardhës. Nominimi i programit përkatës do të behet ne përputhje me rregullat e tregut te energjisë elektrike.

4. Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga OSHEE sh.a, ndaj impianteve prodhues zbatohen Rregullat e Tregut mbi Disballancat, sipas parashikimeve të legjislacionit ne fuqi.

5. Devijimet nga programet e paraqitura do të trajtohen ne perputhje me Rregullat e Tregut te Energjise Elektrike apo cdo akti tjetër te miratuar nga ERE per kete qellim.

Neni 6

- 6.1 ~~Palët e tregut të energjisë elektrike të livruar nga Shitësi dhe Blerësi do të kryejnë një procesverbal për matjen dhe kontrollimin e matjes së Energjisë Elektrike të livruar nga Shitësi dhe Blerësi.~~ **Matja e Energjisë Elektrike të Livruar nga Shitësi dhe Blerësi**
1. Matja e Energjisë Elektrike të livruar nga Shitësi te Blerësi do të kryhet në Pikën e Matjes/Livrimit, e cila do te jete ne pronesi te Shitesit, konform rregullave të përcaktuara në Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike. Për përcaktimin e instalimit, mirëmbajtjes, kontrollit, testimin dhe vulosjes së Sistemit të Matjes të Energjisë Elektrike, Palët i referohen Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.
 2. “Kur prodhuesi/shitësi vendos te operoje si ne tregun e rregulluar si ne tregun e pa rregulluar, impiantet prodhuese duhet te jene te pajisur me sistem telematje me baze orare te integruar me sistemin e matjes se OST”.
 3. Matësi kontrollohet, kolaudohet dhe vulozet në prezencë të subjektit të autorizuar të Shitësit dhe OSHEE Sh.a.
 4. Kolaudimi kryhet në Subjektet e autorizuar dhe certifikuar sipas Kodit të Matjes së Energjisë.
 5. Në ditën e caktuar nga Palët në Kontratë (ose në ditën e fundit të Muajit përkatës), përfaqësuesit e autorizuar të Shitësit dhe Blerësit do të takohen për të lexuar aparatin matës të Energjisë Elektrike/ose do te lexojne online nga sisteme te aksesueshme nga te dyja palet sasinë Mujore të Energjisë së livruar nga Shitësi te Blerësi çdo muaj. Tregimi i numeratorit të matësit do të lexohet dhe regjistrohet ne vend apo nepermjet aparaturave elektronike online me sisteme te aksesueshme nga te dyja palet çdo Muaj për të realizuar kryerjen e bilancit të shitblerjes së Energjisë Elektrike. Në rast të mosfunksionimit të Sistemit të Matjes për shkak të defekteve, marrja e të dhënave do të përcaktohet me marrëveshje midis Palëve duke iu referuar rregjistrave të leximit te matjes.
 6. Per leximin e matjes te realizuar sipas pikes 6.3 te ketij neni, do të mbahet një procesverbal (akt- rakordim) i leximit të aparatit matës, që do të firmoset nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve që kryejnë leximin, me përmbajtjen si më poshtë:
 - a. Të dhënat e Sistemit te Matjes (aparati matës dhe transformatoret e matjes);
 - b. Identitetin e personave që bëjnë leximin;
 - c. Nënshkrimin e personave;

- (d) Leximin e matësit për muajin paraardhës;
 - (e) Leximin aktual të matësit.
7. Shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregullave në fuqi dhe do t'i dërgojë Blerësit faturën apo mundesoje atij leximin online me sisteme të aksesueshme nga të dyja palet. Blerësi është i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e Blerësit, do të jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në Muajt e ardhshëm.
 8. Blerësi duhet të mbajë në impiantet/instalimet perkatëse të prodhimit të Energjisë Rregjistrit (manual) të leximit të Matesit i cili duhet t'i vihet në dispozicion për inspektime/testime përfaqësuesve të autorizuar të Blerësit dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut që kanë akses ligjor.
 9. Në cdo rast përfaqësuesit e autorizuar të OSHEE Sh.a, në bazë të Kodit të Matjes dhe me cilësinë e Blerësit të Energjisë mund të kryejnë konform legjislacionit në fuqi inspektime dhe testime të Sistemit të Matjes dhe sistemet e tyre të rregjistrimit. Punonjësi i impiantit perkatës do t'i veje në dispozicion përfaqësuesve të OSHEE Sh.a rregjistrin e leximit të Matesit të Energjisë Elektrike dhe do t'i krijojë aksesin e nevojshëm për të kontrolluar Sistemin e Matjes.
 10. Mbas instalimit të Sistemit të Matjes dhe rregjistrimit të të dhënave online, Shitësi është i detyruar të beje transmetimin e këtyre të dhënave sipas këtij sistemi, përveç rasteve të pamundësive teknike për montimin e sistemit on-line të matjes.

Neni 7

Dokumentimi i Procesit të Livrimit/Pranimit dhe Matjes

1. Sipas një kërkesë të arsyeshme, Palët:
 - a. do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë, i cili evidenton sasinë, livrimet dhe pranimet e Energjisë Elektrike për qëllimet e përcaktimit të masës dhe shkakut të çdo devijimi nga programet;
 - b. do të ndajnë mes tyre cdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të verifikuar mospërputhjet mes flukseve të programuara dhe reale të energjisë elektrike.
2. Nëse njëra Palë, me kërkesë të Palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga Pala tjetër, kryen shpenzime të arsyeshme të jashtme, për të verifikuar nëse Pala tjetër ka dështuar të përmbushë siç duhet detyrimet e saj sipas termave të kësaj Kontrate këto shpenzime do të rimbursohen nga Pala që nuk ka përmbushur detyrimet, nëse kjo kërkohet.

Neni 8

Faturimi dhe Pagesa

1. Fatura: Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit për livrimin e Energjisë Elektrike një faturë sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasinë totale të Energjisë Elektrike të shitur prej tij në Muajin kalendarik paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të Muajit pasardhës (ose kur kjo date është pushim zyrtar, ditën pasardhese të punës). Krahas faturës, Shitësi

do t'i dorëzojë Blerësit edhe akt-rakordimin përkatës.

2. Pagesa: Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës Mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e pranimin të fatures nga Blerësi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.
3. Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në kete Kontrate, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, konsiston në pagimin e kamatvonesë ne masen e normes se interesit te bonove thesarit me maturim 1 vjekar + 0.5% ne Vit per cdo dite vonese te llogaritura nga data ne te cilen do te kryhej pagesa. Kamatvonesa paguhet pa qenë i detyruar kreditori (Shitësi) të provojë ndonjë dëm. Në llogaritjen e kamatvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.
4. Shumat e diskutueshme: Për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga Shitësi ose Blerësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda Muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakesimet) nga korrektimet do të reflektohen në Muajt pasardhës.

Neni 9

Detyrimet mbi Taksat dhe Tatimet

1. Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me të gjitha tarifatat, taksat, tatimet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi në ose/dhe para Pikës së Livrimit dhe Blerësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi pas Pikës së Livrimit.

Neni 10

Risku dhe Humbja

1. Palet ne fillim të çdo Viti do te hartojne dhe do te koordinojne programet e remonteve te planifikuara si dhe sherbimet per centralin dhe te linjave dhe pajisjeve Elektrike te OSHEE Sh.a.
2. Shitësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të jetë përgjegjës për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me programimin, transmetimin dhe livrimin e sasisë së Energjisë Elektrike të kontraktuar deri në Pikën e Livrimit, ne perputhje me Rregullat e Tregut te Energjise Elektrike dhe akteve te tjera ne fuqi, përveç rastit kur livrimi i Energjisë është i pamundur si rezultat i rrethanave që nuk varen nga Shitësi ose në rast se moslivrimi justifikohet nga riparimet vjetore dhe mirembajtjes sipas pikes 1 te ketij neni.
3. Blerësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me pranimin dhe transmetimin e sasisë së kontraktuar pas Pikës së Livrimit, përveç rastit kur moslivrimi i Energjisë është i pamundur si rezultat i rrethanave që nuk varen nga Blerësi (Force Madhore) ose

në rast se moslivrimi justifikohet nga avarite ne linjat dhe pajisjet Elektrike te Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Neni 11

Çmimi

1. Blerësi paguan Shitësin për Energjinë Elektrike të blerë, me cmimin e percaktuar dhe të miratuar nga ERE sipas legjislacionit ne fuqi.
2. Cmimi i aplikueshem ne momentin e lidhjes se kesaj Kontrate eshte cmimi ne fuqi i percaktuar dhe miratuar nga ERE.
3. Ne se ERE miraton nje cmim te ndryshem nga ai i aplikuar sipas paragrafit 11.2 Palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme për sasi të e faturuara ne perputhje me vendimin perkates se ERE.
4. ERE percakton dhe miraton me vendim brenda vitit aktual, çmimin e shitjes së energjisë për vitin pasardhës. Nëse çmimi vjetor miratohet më vonë se fillimi i vitit pasardhës, ky çmim do të jetë i zbatueshëm që nga data 1 Janar e vitit pasardhës dhe palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme në faturat përkatëse për sasi të e lëvuara dhe të faturuara para miratimit të çmimit, në përputhje me vendimin përkatës të ERE..

Nëse ERE miratim e nevojshme për sasi të e faturuara para miratimit të çmimit, në përputhje me vendimin përkatës të ERE..

Neni 12

Forca Madhore

1. Në qoftë se secila Palë përballet me Forcën Madhore, ajo do te njoftojë Palën tjetër pa vonesë nëpermjet një njoftimi me shkrim të konfirmuar si e marrë nga Pala tjetër, duke i bërë të qartë kësaj të fundit natyrën e ngjarjes, kohëzgjatjen e mundshme dhe pasojat e pritshme.
2. Asnjëra Palë nuk do të konsiderohet përgjegjëse për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore në qoftë se ajo ka qenë penguar për realizimin e tyre nga Forca Madhore.
3. Palët do të ndërmarrin masat e nevojshme për të reduktuar minimalisht dëmet.

Neni 13

Kompensimet për Mos Pranimin e Energjise Elektrike

1. Kur Bleresi nuk permbush detyrimin për të pranuar Energji nga Shitesi sipas kesaj Kontrate dhe kur një mospërmbushje e tillë nuk justifikohet nga një rast i Forcës Madhore, atëherë Blerësi duhet të kompensojë Shitesin per dëmin financiar të shkaktuar, të barabartë me produktin sasisë se Energjisë të papranuar me çmimin e rregulluar nga ERE, në fuqi.
2. Shuma e paguar në përputhje me këtë nen, do të faturohet dhe paguhet sipas nenit 8 (Faturimi dhe Pagesa).
3. Asnjëra nga Palët nuk do të jetë e detyruar të kompensojë humbjet e Palës tjetër si rezultat i riparimeve apo mirëmbajtjes (përfshirë këtu edhe riparimet e urgjencës)

te realizuara ne perputhje me programin e rene dakort nga Palet.

Neni 14

Përfundimi Kontratës

1. Palët kane të drejtë të përfundojnë Kontratën në qoftë se reciprokisht bien dakord për këtë gjë. Palet njoftojne ERE brenda 5 ditesh per përfundimin e Kontrates.
2. Në qoftë se gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës secila Palë vëren një shkelje serioze të detyrimit Kontraktor nga ana e Palës tjetër, menjëhere do ta njoftojë këtë të fundit me shkrim lidhur me këtë.
3. Pala tjetër brenda një afati kohor prej 10 ditësh nga marrja e njoftimit duhet të ndreqë ose kompensojë shkeljen e pretenduar të detyrimit Kontraktor ose në rast të mospajtit lidhur me pretendimin do t'i shprehë Palës tjetër me shkrim këtë mospajtim duke përcaktuar në të edhe argumentimet e veta per këtë.
4. Në qoftë se brenda afatit 10 ditor si më sipër nuk është bërë ndreqja apo kompensimi i shkeljes Kontraktore ose Pala që ka bërë shkeljen nuk i ka shprehur Palës tjetër mospajtimin me shkrim brenda këtij afati, atëhere Pala që pretendon shkeljen mund te kerkoje zgjidhjen e njeanshme te Kontrates.
5. Palët do të kenë të drejtë të kerkojne përfundimin e Kontratës në mënyrë të njëanshme në qoftë se ato nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet Kontraktore sipas kësaj Kontrate për një periudhë kohore pa ndërprerje më shumë se 6 muaj si rezultat i Forcës Madhore.
6. Palet kane te drejte te kerkojne përfundimin e Kontrates kur:
 - a) Njëra nga Palët falimenton ose nuk është në gjendje të paguajë borxhet ose dështon, ose pranon me shkrim paaftësinë e saj të përgjithshme për të paguar borxhet kur duhet;
 - b) Në rast se njëra nga Palet ka dhënë garanci jokorrekte dhe të pavërteta;
 - c) Në rast te shkeljes nga ana e Paleve te rregullave dhe kerkesave teknike te parashikuara nga aktet nenligjore ne fuqi.
7. Përfundimi i Kontrates sipas paragrafeve 14.4, 14.5, 14.6 te ketij neni behet me miratimin e ERE.
8. Palët do të llogarisin brenda 30 ditëve pune duke filluar nga dita e përfundimit të Kontrates, detyrimet financiare respektive dhe mënyrat e shlyerjes së tyre.
9. Duke patur parasysh prashikimet e VKM nr. 244, datë 30.03.2016, nese kjo kontrate do te ndryshoje,apo zgjidhet si rrjedhojë e një akti normativ të ERE, apo te drejtat dhe detyrimet e saj do te transferohen, në kuadër të zbatimit të legjislacionit ne fuqi qe rregullon sektorin e energjise elektrike dhe burimeve te rinovueshme dhe jo nga vullneti i secilës palë, pala që mund të kërkojë zgjidhjen është e detyruar të njoftojë palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara ndryshimit, transferimit apo përfundimit të kontratës, nese ne legjislacionin e ri nuk parashikohet ndryshe. Në një rast të tillë palët

Miratar me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERF-s,
ndryshuar

do të zbatojnë parashikimet e pikës 8 të këtij neni për likuidimin e detyrimeve financiare
midis tyre.

Neni 15

Afati i Kontrates

1. Kjo Kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15 (pesëmbëdhjete) vjeçare., (Për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a para apo në kohën e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 101, datë 23.06.2016 të ERE, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me OSHEE sh.a do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me KESH sh.a.)
2. Nëse Shitësi ka një kontratë të shit-blerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a para apo në kohën e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 101, datë 23.06.2016 të ERE, Blerësi garanton se Shitësi do të vazhdojë të gëzojë të drejtat e parashikuara në kontratën e mëparshme me KESH sh.a dhe çdo ndryshim të miratuara nga ERE për gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate.

Neni 16

Hyrja në Fuqi

Kjo Kontratë dispozitat e të cilave janë miratuara nga ERE hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga Palet.

Neni 17

Ndryshimet

Në qoftë se ndonjë term, kusht apo rregull i kësaj Kontrate do të bëhet i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm plotësisht apo deri në njëfarë mase, ky term, kusht apo rregull nuk do të sjellë pavlefshmërinë, paligjshmërinë apo pazbatueshmërinë e kushteve, termave dhe rregullave të parashikuara më pjesën tjetër të kësaj kontrate.

Neni 18

Legjislacioni

Kontrata për shit-blerjen e Energjisë Elektrike do të bazohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

Njoftimet

1. Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tjetër sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në Kontratë.
2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 20

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Në rast të mosmarrëveshjeve, Blerësi dhe Shitësi do të bëjnë fillimisht përpjekje të zgjidhin konfliktin me mirëkuptim. Nëse Palët nuk gjejnë mirëkuptim, ato mund të kërkojnë ndërhyrjen e ERE-s.
2. Palet në rast kanë të drejtën e zgjidhjes së konfliktit në rrugë gjyqësore ose në arbitrazh sipas percaktimeve të bera nga vete Palet. Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis Palëve, që rrjedhin nga kjo kontratë do të jetë Gjykata e

Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 21

Personat Përgjegjës (Administratorët) e Kontratës

1. Secila Palë do të caktojë në këtë Kontratë personin që do të jetë përgjegjës, për interes të Palës respektive, për kryerjen e komunikimeve përkatëse dhe për përfaqësimin e saj në problematikat që lidhen me ekzekutimin e kësaj Kontrate.
2. Secila Palë do të njoftojë menjëherë Palën tjetër për ndonjë ndryshim lidhur me personin e caktuar përgjegjës. Nëse ndonjëra nga Palët nuk bën informimet e duhura, atëherë pala do të marrë mbi vehte të gjitha përgjegjësitë lidhur me ndonjë dëm të mundshëm që rrjedh si rezultat i mosdhënies së informacionit të nevojshëm.
3. Personat përgjegjës e kësaj Kontrate për Palet, sipas paragrafit të parë të këtij neni, do të jene perkatesisht:

Për Blerësin: _____,

Për Shitësin: _____,

Neni 22

Kjo Kontratë hartohet në 4 kopje të barasvlefshme nga të cilat 2 kopje qëndrojnë në OSHEE Sh.a dhe 2 kopje e mban Shitesi.

Per Shitesin

Per Bleresin

Emertimi Juridik

Personi I autorizuar

Funksioni

Nenshkrimi dhe Vula
